LIGJ
Nr. 102/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 133/2013,
"PËR SISTEMIN E PAGESAVE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 133/2013, "Për sistemin e pagesave" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shkronjat "k" dhe "l", të nenit 5 ndryshohen, si më poshtë:

"k) "Institucion" nënkupton:

i. një institucion krediti sipas përkufizimit në pikën 13/2, të nenit 5, të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave", të ndryshuar;

ii. një subjekt që kryen veprimtari bankare ose financiare, përfshirë shërbime pagesash, ushtrimi i veprimtarisë së të cilit rregullohet me ligj të veçantë;

iii. Bankën e Shqipërisë dhe banka qendrore të huaja;

iv. një shoqëri komisionere, veprimtaria e së cilës rregullohet sipas legjislacionit për tregjet e kapitalit;

v. autoritetet publike dhe subjektet, detyrimet e të cilave janë të garantuara me fonde publike; ose

vi. institucionet e kreditit ose shoqëritë komisionere të huaja, të rregulluara në mënyrë të ngjashme me institucionet në nënndarjet "i" dhe "iv" të kësaj shkronje, kur institucionet në nënndarjet "i" deri në "vi" të kësaj shkronje marrin pjesë në një sistem pagesash dhe janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga urdhrat e transfertave brenda këtij sistemi;

vii. një institucion pagesash të rregulluar sipas ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave", i ndryshuar, me përjashtim të personit fizik ose juridik që përfiton nga përjashtimet, sipas neneve 27 ose 28, të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave", i ndryshuar; ose

[1] Ky ligj përafron plotësisht nenin 4 të rregullores (BE) 2024/886 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 mars 2024, që ndryshon direktivën 98/26/KE, në lidhje me transfertat e menjëhershme të kreditit në euro, CELEX 32024R0886, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, L 2024/886, datë 19.3.2024.

viii. një institucion të parasë elektronike të rregulluar sipas ligjit nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”, i ndryshuar, me përjashtim të personit juridik që përfiton nga përjashtimet, sipas nenit 28/8, të ligjit nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”, i ndryshuar, kur institucionet në nënndarjet “vii” dhe “viii” të kësaj shkronje marrin pjesë në një sistem, ekzekutojnë urdhërtransferta sipas përcaktimeve të nënndarjes “i”, të shkronjës “t” të këtij neni, dhe janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve financiare, të cilat rrjedhin nga këta urdhra transfertash brenda këtij sistemi.

Për qëllime të këtij ligji, institucion mund të konsiderohet nga Banka e Shqipërisë edhe një subjekt që merr pjesë në një sistem të rregulluar nga ky ligj dhe ekzekuton vetëm urdhra transferte, sipas përcaktimeve të nënndarjes “ii”, të shkronjës “t” të këtij neni, si dhe ekzekuton pagesat që rezultojnë nga këta urdhra, i cili ka përgjegjësi për shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga urdhrat e transfertave brenda këtij sistemi, me kusht që të paktën tre pjesëmarrës të këtij sistemi të përfshihen në kategoritë e mësipërme dhe një vendim i tillë të jetë i garantuar për shkak të rrezikut sistemik.

l) “Pjesëmarrës” është një institucion, një shtëpi klerimi, një agjent shlyerës, një operator sistemi, një kundërpalë qendrore ose një anëtar klerimi i një kundërpale qendrore, që ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin për tregjet e kapitalit.”.

Neni 2

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1
Pjesëmarrësi

Pjesëmarrësi, sipas përkufizimit në shkronjën “l”, të nenit 5 të këtij ligji, në përputhje me rregullat e sistemit mund të veprojë edhe si kundërpalë qendrore, agjent shlyerës ose shtëpi klerimi ose të kryejë një pjesë ose të gjitha këto detyra.”.

Neni 3

Në fund të nenit 16 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Megjithatë, edhe në këtë rast, nuk do të kufizohet përgjegjësia e pjesëmarrësit nëpërmjet të cilit nënpjesëmarrësi kalon urdhërtransfertat në këtë sistem.”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.10.2026.

Shpallur me dekretin nr. 528, datë 23.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj